



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

eTwinning komuniteti për shkollat në Evropë

2014-10-27 13:03:00

MAS fton mësuesit të anëtarësohen në komunitetin online e-Twinning dhe të jenë pjesë aktive e këtij programi.



Si pjesë e integritit në programin European Erasmus+, për Edukimin, Trajnimin, Rininë dhe Sportet, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka përfituar një grant, duke u bërë në këtë mënyrë aktualisht partnere e e-Twinning – Komuniteti online i shkollave në mbarë Europën.

eTwinning promovon bashkëpunimin e shkollave në Evropë nëpërmjet përdorimit të Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit duke ofruar mbështetje, mjete dhe shërbime për shkollat.

Portali eTwinning (www.etwinning.net) përfaqëson një platforme unike të bashkëveprimit të mësuesve në projekte nxitëse dhe inovatore. Portali nxit nxënësit, mësuesit dhe drejtuesit e shkollave, të krijojnë projekte, të shkëmbejnë ide dhe të perhapin praktikën më të mirë ndërmjet tyre, duke ndjerë të jenë pjesë e komunitetit me nxitës në Europë.

I krijuar në vitin 2005 si veprimi kryesor i Programit të Mësimin Elektronik të Komisionit Evropian, eTwinning numëron sot në gjithë kontinentin Evropian 269,593 mësues dhe 128,352 shkolla që zhvillojnë projekte bashkëpunuese dhe ndajnë ide.

MAS fton mësuesit të anëtarësohen në komunitetin online e-Twinning dhe të jenë pjesë aktive e këtij programi.

● eTwinning suporton iniciativën ‘Move2Learn, Learn2Move’

Me rastin e 30 vjetorit të Erasmus, Komisioni Evropian ofron mundësi të reja për të rinjtë për të udhëtuar dhe zbuluar Evropën.

Me këtë nismë të re, të rinjtë e angazhuar në projektet arsimore do të kenë mundësi të udhëtojnë në Europë për të takuar partnerët e tyre evropianë. Pritet që rreth 5000 deri 6000 studentë të marrin secili nga një biletë udhëtimi.

eTwinning ka mundësi të zgjedhë përfituesit e kuponave të udhëtimit, të cilët do të identifikohen nga mësuesit dhe nxënësit e moshës më të madhe se 16 të cilët kanë marrë pjesë në projektet eTwinning dhe kanë fituar këtë vit

. Prioritet do t'u jepet projekteve që kanë të bëjnë me temën e Aplikimi, vlerësimi, dhe periudha e përzgjedhjes do të zhvillohen gjatë muajit qershor dhe korrik. Mësuesit dhe studentët do të jenë në gjendje të fillojnë udhëtimet në gusht.

Etiketën kombëtare të Cilësisë "Përfshirjes"

● Takime mbreselene për Drejtuesit e shkollave. Angazhim dhe perkushtim në nxitjen dhe përfshirjen e mësuesve në platformen eTwinning dhe School Education Gateway.

Në kuadrin e planit të aktiviteteve që Shërbimi Kombëtar po ofron, u organizua në Tiranë në ambjentet e "Sami Frasherit" takimi me Drejtuesit me teme: "eTwinning një hapësirë e re e komunitetit ndërkombëtar të mësuesve" Ky aktivitet synoi përfshirjen e

drejtuesve të shkollave si promotore të shpirtit të bashkëpunimit dhe mesuesve të tyre në platformën eTwinning, si nxites të angazhimit të tyre në binjakëzimin e shkollës në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë takim drejtuesit u sensibilizuan për mundësitë që eTwinning ofron, ecurinë e përfshirjes së shkollave në këtë platformë, angazhimet aktuale të mesuesve në projekte të përbashkëta. Gjithashtu për herë të parë u prezantua platforma evropiane School Education Gateway, ku mesuesit dhe drejtuesit kanë mundësi të informohen në kohë reale në lidhje me të rejtat në fushën e arsimit, aktivitetet e organizuara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në arsim, trajnime dhe mundësi të zhvillimit profesional të mesuesve. Në këtë takim Drejtuesit debatuan dhe sugjeruan rruge dhe forma të ndryshme për përfshirjen dhe angazhimin e mesuesve në programin eTwinning. Ata u informuan edhe për mbështetjen që Shërbimi Kombëtar eTwinning do të japë në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm profesional të mesuesve. Gjithashtu ata u informuan për procesin e konkurrimit në të cilën janë përfshirë shkollat për të festuar së bashku ditën ndërkombëtare eTwinning, nëpërmjet aktiviteteve që lidhen me diversitetin dhe ndikimin që teknologjia duhet të japë në jetën sociale të të rinjve. Në takim më tej pjesë e drejtuesve të shkollave të mësuara e 9-vjeçare nga disa zona si Tirane, Durrës, Elbasan, Fier, Vlorë, Shkoder e Lezhë.

● **Javët eTwinning - Qytetaria Digjitale, #eTwCitizen16**

Javët eTwinning të këtij viti, 10-27 tetor, do të përqendrohen në "Qytetarinë Digjitale"- se si eTwinning mund të zhvillojë gjeneratën e ardhshme të qytetarëve aktiv të Evropës.

#eTwCitizen16 do të jetë rreth krijimit të projekteve nga mësuesit rreth temës së qytetarisë digjitale. Kjo fushatë synon angazhimin e mësuesve, nxënësve, anëtarëve të sistemit arsimor të gjenerojnë projekt ide që lidhen me Qytetarinë Digjitale, për të qenë pjesë e kompeticionit ndërkombëtar për projekt idetë më të mira. Të gjitha projektet e krijuara si pjesë e fushatës së qytetarisë digjitale do të hyjnë në një konkurs duke përdorur hashtagun #eTwCitizen16 në përshkrimin e tyre të projektit. Themeluesit e projektit fitues, të cilët do të shpallen më 17 nëntor, do të marrin pjesë në një kurs Future Classroom Lab në Bruksel. Merrni pjesë duke regjistruar projekte në platformën

www.etwinning.net

● **Minipanairet: "eTwinning - sfidë dhe oportunitet për Qytetarinë Digjitale"**

Si pjesë e programit eTwinning, Shërbimi Kombëtar eTwinning – Ministria e Arsimit dhe Sportit, do të organizojë në katër rajone gjeografike Minipanairet me temë: "eTwinning - sfidë dhe oportunitet për Qytetarinë Digjitale". Ky panair synon të prezantojë angazhimet aktuale të mësuesve të përfshirë në këtë program dhe të promovojë njëkohësisht pjesëmarrjen e mësuesve të rinj për të qenë pjesë aktive e këtij programi. Njëkohësisht ky panair do të ofrojë mundësinë e regjistrimit online të mësuesve të rinj, të panjohur me parë me platformën eTwinning si dhe trajnimin e tyre duke demonstruar njëkohësisht funksionalitete që lidhen me dizajnimin dhe implementimin e një projekti, si dhe funksionalitete me përdorimin e TwinSpace si një mjet për komunikim, bashkëpunim dhe ndarje eksperiencash. Koordinimi i Shërbimit Kombëtar për organizimin e këtyre Minipanireve aktualisht po bëhet nëpërmjet DAR/ZA, të cilat njoftojnë dhe koordinojnë shkollat për pjesëmarrje. Shërbimi Kombëtar përzgjedh nga platforma listën e mësuesve që mund të demonstrojnë aktivitetin e tyre në Minipanair. Mësuesit e kësaj liste janë mësues të cilët kanë rezultuar aktivë në platformën eTwinning dhe realisht kanë mundësinë e paraqitjes së projekteve të realizuar për kompeticionin rajonal që do të jete pjesë e këtij Minipanairi. DAR/ZA koordinon veprimet me shkollat përkatëse të këtyre mësuesve për të krijuar lehtësirat e përgatitjes për t'u paraqitur në këtë Minipanair. Shërbimi kombëtar me shpenzimet e tij do të garantojë ambientin e panairit, hapësirat e promovimit brenda këtij ambienti (tavolina), dhe disa mjete prezantuese si fletëpalosje, stilolapsa, rollup, poster

dhe kalendarë. Shkollat e këtyre mësuesve, vet ne varësi te projekteve qe duan te paraqesin te mundësojnë paraqitjen dinjitoze ne ketë panair. Secili nga këta mësues do te ketë hapësirën e tij dhe mund te marre një partner ne projekt dhe te paktën 2 nxënës. Mësuesit duhet te paraqesin projektet e tyre ne formën e prezantimeve ne Power Point ne tablet ose laptop si dhe me foto, postera, fletëpalosje, ose objekte te tjera. Panairi vizitohet nga mësues e nxënës te tjerë te cilët do te kenë mundësi te votojnë tre projektet me te mira ne nivel rajonal.